



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

**Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

## **AKTIVITET E ZHVILLUARA NË SEKTORIN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL GJATË PERIUDHËS PRILL-QERSHOR 2022**

- ❖ Inicimi i procedurave të prokurimit për projektet e planifikuara.
- ❖ Ftesa publike për projektin “Përkrahja me shoqëri bletësh”.
- ❖ Shqyrtimi i kërkesave në intranet
- ❖ Shqyrtimi i kërkesave për dëme në bujqësi
- ❖ Pranimi i 157 aplikacioneve në projektin “Përkrahja me shoqëri bletësh”.
- ❖ Përzgjedhja e fermerëve të cilët nuk kanë përfituar nga viti 2018.
- ❖ Pjesëmarrje në komisione dhe vlerësime të ndryshme.
- ❖ Regjistrimi i fermerëve të rinjë, dhe paisja me NIF sipas kërkesave të fermerëve
- ❖ Informata dhe këshilla të vazhdueshme për fermerë sipas kërkesave të tyre
- ❖ Publikimi i ftesës për aplikim në projektin “Përkrahja me mëshqerra”, me ç’rast përfitues të projektit do jenë gjithsej 108 fermerë.
- ❖ Vizita e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e ofertave në projektin e inicuar për “Përkrahjen e fermerëve me shoqëri bletësh” në Pejë, Gjakovë, Dumnicë. Gllamnik.
- ❖ Pranimi i aplikacioneve për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2022 nga dt.26.04.2022 deri me datë 01.06.2022.
- ❖ Ftesa publike për përkrahjen e fermerëve me serra bujqësore 96m<sup>2</sup> dhe pranimi i aplikacioneve sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën “Qatar Charity”
- ❖ Paisja e aplikuesve me vendime për pagesë për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

- ❖ Përgatitja e listës së 108 fermerëve përfitues për subvencionim me mëshqerra, shpërndarja e tyre për fermerët, përgatitja e kontratave si dhe shpërndarja e dokumentacionit të mëshqerrave për përfituesit.

## **AKTIVITET E ZHVILLUARA NË SEKTORIN E PYLLTARISË GJATË PERIUdhËS PRILL-QERSHOR 2022**


- ❖ Realizimi i konfiskimeve të masës drusore në sasi prej 86.31 m<sup>3</sup> dru zjarri dhe 4.80 m<sup>3</sup> dru teknik.
- ❖ Pranimi i gjithsej 61 fletëparaqitjeve kundërvajtëse me vëllim prej 124.84 m<sup>3</sup> dhe vlerë monetare 1,7037.90euro, si dhe 10 fletëparaqitjeve penale me vëllim prej 36.14 m<sup>3</sup> dhe vlerë 4881.52euro nga rojet e pyllit për prerje ilegale në pyje shtetërore në vëllim të përgjithshëm prej 160.98m<sup>3</sup> dhe në vlerë prej 21919.50euro, të cilat janë përcjellur në Gjykatën Kundërvajtëse dhe në Prokurori.  
Përfundimi i katër revizioneve pyjore në REP Popovë, REP Sylevicë, REP Sekiraqë dhe REP Turuçicë me qëllim të konstatimit dhe regjistrimit të gjendjes ekzistuese sa i përket dëmeve pyjore.
- ❖ Pranimi i gjithsej 27 aktvendimeve kundërvajtëse me vëllim prej 70.30 m<sup>3</sup> dhe vlerë 8555.81euro.
- ❖ Paisja e 67 pronarëve të pyjeve private me leje për prerje të pyllit në prona private.
- ❖ Vazhdimi i punimeve në ngastrën 233/04 –Pakashticë e Epërme për prerje selektive, sipas udhëzimeve të inxhinierëve të APK-së.
- ❖ Inicimi i procedurave për tenderimin e masës drunore në ngastrat 16-0, 18-0, 167/02, 234/04.
- ❖ Përcjellja (shitja) e masës drunore në sasi prej 349.63m<sup>3</sup> dru zjarri dhe 31.68 m<sup>3</sup> dru teknik nga depoja e përkohshme e pylltarisë në fshatin Peran.
- ❖ Pjesëmarrja e zyrtarëve të pylltarisë së bashku me ekipet e zjarrëfikësve në shuarjen e zjarreve.
- ❖ Raportimi i rregulltë në baza mujore në DKR të APK-së lidhur me gjendjen e pylltarisë në Komunën tonë.

- ❖ Pjesëmarrje në komisione dhe vlerësime të ndryshme
- ❖ Realizimi i kontrollave të rregullta nga zyrtarët e pylltarisë në Rajone Ekonomike Pyjore.

Podujevë

Nr. 02-409/04-0055420/22

07 korrik 2022



Drejtori

Fatmir Rudari